

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7155
E shtunë, 30 mars 2024
Çmimi 0.50

Fillon aplikimi për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për zgjedhjet në katër komunat veriore | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

POZITA DHE OPOZITA VAZHDOJNË DEBATIN PËR ZGJEDHJET E REJA | FAQE 5



Partitë e opozitës edhe të premtën kanë bërë thirrje që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, me kërkesën që qeveria Kurti të japë dorëheqje. Por mungon vullneti i mazhorancës që kjo të ndodhë

përmes dorëheqjes. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka theksuar se ky është një rast i rrallë ku të gjitha partitë pajtohen të shkojnë në zgjedhje, por nuk po arrijnë që

kjo punë të bëhet. "Kryeministri Kurti është dorëzuar dhe veç një qëllim e ka: se si ta gjejë një formë për t'ia lënë fajin opozitës për të shkuar në zgjedhje", ka thënë shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri

LAJÇAKU, POZITË TË RE NGA SHTATORI | F. 3



STATISTIKAT E INFRASTRUKTURËS, KURTI: DO T'I PËRFUNDOJMË PUNËT QË QEVERTË E MËHERSHME I LANË KEQ E NË GJYSMË | F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

OPINION

OPOZITA DUHET T'I REFUZOJË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME NË KOSOVË | F. 7

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



HUMNERAT DHE MAJAT E SHPIRTIT ISHULLOR NË "ENCIKLOPEDI NË IMAGJINARE" TË BAJRAM KOSUMIT | F. 7

Nga Ismail
SYLA



AKTUALE



BE-ja: ZBATIM I PLOTË I MARRËVESHJES BAZË PAVARËSISHT VENDIMIT NË KËSHILLIN E EVROPËS | F. 2

EKONOMI

MURATI THOTË SE QARKULLIMI I BIZNESEVE PËR MUAJT JANAR DHE SHKURT KA SHËNUAR RITJE, I REAGON OPOZITA | F. 7

KOSOVA DHE MALI I ZI NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN E PROGRAMIT NDËRKUFITAR IPA III, PËRFITOJNË MBI 8 MILIONË EURO | F. 7

SPORT



UJKANI: DO TË JEMI MAKSIMALISHT TË PËRGATITUR PËR LIGËN E KOMBEVE | F. 12

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani do ta vizitojë ShBA-në në maj

Ankara, 29 mars - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, do t'i vizitojë Shtetet e Bashkuara më 9 maj, tha një zyrtar turk i sigurisë, duke i hapur rrugë takimit të parë të udhëheqësit turk në Shtëpinë e Bardhë gjatë administratës së presidentit amerikan Joe Biden. Vizita në Uashington do të jetë

e para që Erdogan do të zhvillojë që nga viti 2019, kur u takua me presidentin e atëhershëm amerikan Donald Trump, me të cilin ka raporte të mira personale. Që kur është zgjedhur Bideni në pozitën e presidentit më 2020, Ankaraja ka kërkuar që dy udhëheqësit të zhvillojnë një takim kokë më

kokë. Raportet mes dy aleatëve të NATO-s, që përshkruhen me dallime të mëdha në një sërë çështjesh, janë përmirësuar pasi Ankaraja ratifikoi pranimin e Suedisë në NATO në muajin janar, pas 20 muajsh vonës që kishte shkaktuar frustrim në Uashington.



BE-ja: Zbatim i plotë i Marrëveshjes Bazë pavarësisht vendimit në Këshillin e Evropës

BRUKSEL, 29 MARS - Bashkimi Evropian (BE) ka përsëritur të premten se vendimet në Këshillin e Evropës nuk kanë të bëjnë me bllokun drejtpërdrejt, pasi ajo është organizatë tjetër e pavarur evropiane, prandaj u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i zbatojnë detyrimet nga Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve, për të cilën janë pajtuar vitin e kaluar.

I pyetur nga "Radio Evropa e Lirë" nëse Serbia e shkeli këtë Marrëveshje kur votoi kundër raportit të raportueses për Kosovën në Komitetin për Politikë dhe Demokraci të Këshillit të Evropës këtë javë, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha se blloku pret zbatimin e të gjitha pikave të Marrëveshjes pa marrë parasysh veprimet në Këshillin e Evropës. "Pa marrë parasysh këto veprime në Këshillin e Evropës, kur është fjala te dialogu mes Beogradit dhe



Prishtinës, BE-ja vazhdon të presë që të gjitha pjesët e Marrëveshjes nga viti 2023 për rrugën drejt normalizimit, të zbatohet me shpejtësi, në besim të mirë dhe në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, ashtu siç ishin pajtuar palët me aneksin e zbatimit në Ohër", tha Stano.

Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen Bazë në shkurtin e vitit 2023 në Bruksel, ndërsa më 18 mars në Ohër u pajtuar për

Aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Dhe, sipas nenit 4 të Marrëveshjes së shkurtit, Serbia nuk duhet ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare. I pyetur rreth këtij neni, Stano nuk u përgjigj drejtpërdrejt, por përsëriti se, siç thuhet edhe në Aneksin e Ohrit për zbatim të Marrëveshjes, të gjitha pikat duhet të zbatohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. "Këshilli i Evropës

luan rol qendror në promovimin e vlerave fundamentale evropiane dhe standardeve të përbashkëta, përfshirë edhe të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave. U takon shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të vendosin për çështjet që kanë të bëjnë me këtë organizatë, përfshirë edhe anëtarësimin", shtoi ai. Ai në veçanti e përmendi detyrimin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Kjo përfshin edhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, e cila është rruga më konkrete për ta siguruar mbrojtjen e komunitetit serb në Kosovë", shtoi ai.

Stano i akuzoi të dyja palët për moszbatimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve. "Është për keqardhje se, pavarësisht prej përpjekjeve nga ana e BE-së dhe bashkësisë më të

gjërë ndërkombëtare, deri më tash progresi në zbatimin e obligimeve nga kjo marrëveshje, ka qenë shumë i limituar si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia", theksoi Stano.

Më 27 mars Komiteti për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës miratoi raportin e raportueses për Kosovën, Dora Bakoyannis, ku u rekomandua që shteti ka përmbushur kushtet për t'u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës.

Raporti u miratua me 31 vota për, katër kundër dhe një abstenim. Kundër kanë votuar dy deputetë nga Serbia, një nga Mali i Zi dhe një nga Bosnjë-Hercegovina. Asambleja Parlamentare pritet të votojë për anëtarësimin e Kosovës në prill dhe, nëse ajo jep dritën jeshile, atëherë fjalën përfundimtare duhet ta japë Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës në maj.

Polonia aktivizon avionët luftarakë pas sulmeve ruse në Ukrainë

VARSHAVË, 29 MARS - Avionët luftarakë të Polonisë dhe të aleatëve u aktivizuan mëngjesin e 29 marsit, pasi Rusia kreu sulme me raketa në Ukrainë.

Kështu njoftoi Komanda Operacionale e Forcave të Armatosura të Polonisë. "Avionët polakë dhe të aleatëve po operojnë në hapësirën polake, gjë që mund të rezultojë në rritjen e niveleve të zhurmës, veçmas në pjesën jugperëndimore të shtetit", tha Komanda përmes një postimi në X.

Pjesa juglindore e Polonisë është në kufi me Ukrainën. Kievit,



ndërkaq, të premten njoftoi se është përballur gjatë natës me

sulmet ruse me raketa dhe dronë që kanë shënjestruar infrastrukturën energjetike të shtetit.

Aktivizimi i forcave ajrore polake vjen disa ditë pasi presidenti rus Vladimir Putin tha se nuk do të sulmojë asnjë shtet të NATO-s, as Poloninë, shtetet e Baltikut apo Republikën Çeke.

Megjithatë, udhëheqësi rus paralajmëroi se nëse avionët luftarakë F-16 - të prodhimit amerikan - përdoren në Ukrainë, atëherë ato do të rrëzohen nga ushtria ruse. "Sigurisht, nëse këta avionë do të përdoren nga bazat

ajrore nga një shtet i tretë, për ne do të bëhen caqe legjitime", tha Putini.

Ukraina, që po përballet me luftën e nisur nga Rusia më 2022, po kërkon nga aleatët e saj perëndimorë që t'i dërgojnë avionët F-16, në mënyrë që të përballet me forcat pushtuese ruse.

Belgjika, Danimarka, Norvegjia dhe Holanda janë në mesin e shteteve që janë zotuar se do t'i japin Kievit fluturake të tilla. Ndërkaq, një grup shtetesh kanë premtuar se do të ndihmojnë në trajnimin e pilotëve ukrainas.

Greqia goditet nga një tërmet

Athinë, 29 mars - Një tërmet prej 5.7 ballësh ka goditur të premten pjesën jugore të Greqisë, në brigjet e Peloponezit perëndimor. Nuk ka raportime për dëme apo viktima nga dridhjet e tokës, të cilat u ndien në kryeqytetin grek, Athinë, e deri në ishullin

jugor të Kretës. Epiqendra e dridhjeve të tokës ishte nën shtratin e detit afër ishujve Strofades, që gjenden rreth 120 kilometra në jugperëndim të qytetit Patras, tha Instituti Gjeodinamik i Athinës. Në zonën e epiqendrës së

tërmetit janë regjistruar edhe goditje pasuese me shkallë më të ulët të Rihterit.

Greqia gjendet në një rajon shumë aktiv sizmik dhe tërmetet janë të zakonshme. Shumica e dridhjeve të tokës nuk shkaktojnë viktima dhe pak ose aspak dëme materiale.



Lajçaku, pozitë të re nga shtatori

PRISHTINË, 29 MARS - Në kuadër të rotacionit të madh në postet diplomatike të Bashkimit Evropian nëpër botë, Miroslav Lajçak, që aktualisht është i dërguari i posaçëm i bllokut për dialogun Kosovë - Serbi, pritet të bëhet ambasador i BE-së në Zvicër.

"Radio Evropa e Lirë" ka mësuar nga burimet diplomatike se Lajçaku do ta nisë mandatin në kryeqytetin zviceran, Bern, më 1 shtator të këtij viti.

Ende nuk dihet se kush do ta zëvendësojë Lajçakun në pozitën e të dërguarit të posaçëm për dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Para katër vjetësh, ish-ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Lajçak, ishte emëruar në këtë pozitë. Mandati i tij përfundon në fund të gushtit.

Burimet evropiane thanë se pozita e përfaqësuesit të posaçëm për dialogun do të vendoset më vonë, pas rotacionit të një numri të madh të ambasadorëve të BE-së nëpër botë.



Po ashtu, duhet të vendoset se si do t'i qaset BE-ja në të ardhmen dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjithsesi, në BE do të ketë përpjekje që kjo të vendoset para 1 shtatorit në mënyrë që të mos ketë zbrazëti pas largimit të Lajçakut. Por, kjo do të varet nga qasja që do të ketë përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të

jashtme dhe siguri, i cili do të pasojë në këtë pozitë, Josep Borrellin.

Megjithatë, se kush do të jetë shefi i ri i diplomacisë evropiane dhe cila do të jetë qasja karshi dialogut Kosovë - Serbi, që BE-ja ndërmjetëson që nga viti 2011, do të vendoset pas zgjedhjeve evropiane të qershorit, nga të cilat

do të zgjidhet edhe përbërja e re e Komisionit Evropian.

Lajçaku, gjatë ndërmjetësimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, është akuzuar për "njëanshmëri" në proces nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Në shtator të vitit 2023 Kurti kishte deklaruar se Lajçaku dhe i dërguari i Uashingtonit për

Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, "vijjnë te ne me kërkesa të palës tjetër", duke iu referuar Serbisë.

Këto deklarata ai i kishte bërë kur bashkësia ndërkombëtare po u bënte thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ulnin tensionet në veriun e Kosovës, që u rritën në maj, pas marrjes së detyrës nga kryetarët shqiptarë, në komunat e banuara me shumicë serbe.

Kurti, po ashtu, kishte deklaruar se Lajçaku ishte pozicionuar "kundër Kosovës".

Ndërkaq, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, vazhdimisht e ka kritikuar Bashkimin Evropian për disa masa ndëshkuese që blloku ka ende në fuqi ndaj Kosovës, për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës. Ajo ka thënë se mosheqja e këtyre masave vendos "jashtë binarit" dialogun me Serbinë, proces në të cilin, sipas saj, të dyja palët "duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë".

Osmani ka deklaruar se këto masa ndëshkuese po krijojnë mungesë ekuilibri në dialog.

Fillon aplikimi për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për zgjedhjet në katër komunat veriore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU


PRISHTINË, 29 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka njoftuar qytetarët me të drejtë vote, se ka filluar periudha për aplikim për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni i tyre në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të

mbahet më 21 prill.

Gjatë kësaj periudhe, e cila do të përfundojë më 3 prill 2024, shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit, mund të aplikojnë për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës duke dërguar kërkesën e tyre përmes platformës elektronike e cila është e vendosur në uebfaqen e KQZ-së ose postës. Në rast të refuzimit të aplikimit për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, KQZ-ja ka themeluar Komisionin për Kundërshtimin

Administrativ, ku mund të parashtrahet kundërshtimi kundër njoftimit të KQZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka inkurajuar të gjithë shtetasit e Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës dhe pastaj, pas regjistrimit, të votojnë përmes postës gjatë periudhës e cila fillon më 12 prill dhe përfundon më 20 prill.



Bislimi me drejtoreshën rajonale të BB-së për Ballkanin Perëndimor flasin për programin e tregtisë dhe transportit



PRISHTINË, 29 MARS - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim drejtoreshën rajonale të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Evropë dhe Azinë Qendrore, Xiaqing Yu, e cila shoqërohej nga drejtori i zyrës së Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, Massimiliano Paolucci.

Në takim u fol mbi mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme, ku u

përmend edhe avancimi drejt integritit në SEPA.

Duke vlerësuar bashkëpunimin me Bankën Botërore, zëvendëskryeministri theksoi rëndësinë e mbështetjes për projekte ekzistuese e potenciale e ku kontributi mund të jetë i qenësishëm dhe i rëndësishëm. Ai veçoi Programin e Tregtisë dhe Transportit, i cili parashihet ta përmirësojë infrastrukturën dhe procedurat në pikëkalimet kufitare, si dhe t'i rrisë kapacitetet

dhe konkurrueshmërinë e produkteve vendore, me investime në laboratore testuese e më gjerë.

U diskutua edhe ndërlidhja e Kosovës me rajonin e më gjerë dhe ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës, si katalizatorë për më shumë zhvillim e lehtësim të transportit. Zëvendëskryeministri i falënderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për bisedën si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm e të frytshëm.

Betohet anëtari i ri i KPK-së nga radhët e Prokurorisë Speciale

Prishtinë, 29 mars - Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Ardian Hajdaraj, ka mbajtur takimin e 245 me radhë.

Në fillim të takimit të sotëm ka bërë betimin anëtari më i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Speciale,

Milot Krasniqi.

Anëtarët e Këshillit kanë vendosur që të anulohet vendimi i KPK/nr.262/2024 për transferimin e Prokurorit të Prokurorisë së Apelit në Prokurorinë Speciale si dhe të bëhet Plotësim/Ndryshimi i Vendimit KPK/nr.654/2022 për

themelimin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.

Gjithashtu, anëtarët e Këshillit Prokurorial kanë marrë vendim edhe për Plotësim/Ndryshimin e Vendimit KPK/Nr.48/2024 si dhe kanë shqyrtuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme AA.nr.12/2024.





Pozita dhe opozita vazhdojnë debatin për zgjedhjet e reja

Partitë e opozitës edhe të premtën kanë bërë thirrje që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, me kërkesën që qeveria Kurti të japë dorëheqje. Por mungon vullneti i mazhorancës që kjo të ndodhë përmes dorëheqjes. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka theksuar se ky është një rast i rrallë ku të gjitha partitë pajtohen të shkojnë në zgjedhje, por nuk po arrijnë që kjo punë të bëhet. “Kryeministri Kurti është dorëzuar dhe veç një qëllim e ka: se si ta gjejë një formë për t’ia lënë fajin opozitës për të shkuar në zgjedhje”, ka thënë shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri

në zgjedhje, por nuk po arrijnë që kjo punë të bëhet”, ka thënë ai.

Konjufca ka thënë se nuk është punë e frikës mosshkuarja në zgjedhje por, sipas tij, siç duket, mungon vullneti i mazhorancës që kjo të ndodhë përmes dorëheqjes sepse, siç tha ai, nuk ka arsye që qeveria të japë dorëheqje.

Partia Demokratike e Kosovës tashmë e ka të qartë kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Përveç kandidatit për kryeministër, Bedri Hamza, PDK-ja e ka propozuar 9 qershorin si opsion se kur do të mund të mbaheshin zgjedhjet. Në kontekst të kësaj, shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka deklaruar të premtën se partia më e madhe opozitare është e gatshme për zgjedhje. “Ne jemi partia e vetme që realisht tashmë kemi një platformë të qartë, një kandidat për kryeministër, pra e kemi mandatarin dhe e kemi propozuar 9 qershorin si datë të mundshme për zgjedhje”, ka thënë Tahiri pas mbledhjes së

Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Tahiri është pyetur edhe për idenë e shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës. Për herë të parë Tahiri e ka lënë mundësinë e hapur që të shpërndahet Kuvendi, duke shtuar se ky duhet të jetë një vendim i të gjitha partive, përfshirë LV-në, LDK-në dhe AAK-në. “Sa i përket rrëzimit të qeverisë apo mocionit të mosbesimit që u përmend, ju e dini që deputetët e opozitës prej 120 sa i ka Kuvendi, janë 42 deputetë. Duhet së paku 61 deputetë që ta rrëzojmë qeverinë. Këta numra nuk i kemi dhe nuk mund të hyjmë në një procedurë që nuk mund ta realizojmë. Në anën tjetër, ne për t’i dhënë një dalje nga kjo situatë e rëndë, me nxjerr vendin nga kjo situatë e rëndë, i kemi dhënë një rrugë më të lehtë partisë në pushtet, LV-së, që ta shpërndajmë Kuvendin. Nëse ka vullnet të vërtetë nga LV-ja dhe partnerët e saj nga komuniteti joshumicë, e PDK-ja, atëherë janë dy të tretat. Ne preferojmë që ky të jetë një

bashkëpunim më i gjerë me LDK-në dhe AAK-në. Ne jemi të vendosur dhe normalisht se do të marrim hapa konkretë që do të çojmë deri te shpërndarja e Kuvendit”, ka thënë Tahiri.

Në kërkesën e medieve për propozimin e PDK-së për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 9 qershor, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar se AAK-ja po diskuton me grupet parlamentare dhe shumë shpejt do të ketë një qëndrim. Ai ka thënë se AAK-ja është që vendi të shkojë në zgjedhje sa më shpejt. “AAK-ja e ka pozicionin më komod në këtë temë. Ne jemi për të shkuar në zgjedhje sa më shpejt që është e mundur, por mendojmë që kjo qeveri duhet të shkarkohet. Kemi qenë të parët që kemi propozuar iniciimin për shkarkimin e kësaj qeverie ose të japë dorëheqje. Kryeministri Kurti është dorëzuar dhe veç një qëllim e ka: se si ta gjejë një formë për t’ia lënë fajin opozitës për të shkuar në zgjedhje”, ka thënë Tahiri.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 MARS - Debati për zgjedhjet e reja të parakohshme në Kosovë po vazhdon mes pozitës dhe opozitës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të premtën ka folur lidhur me deklaratat e fundit të partive

politike për zgjedhjet, bllokimin e marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe mosthemelimin e komisioneve hetimore.

Konjufca në një deklaratë për media tha se, aq sa është në dijeni, nuk ka pasur ndonjë takim të rëndësishëm ku është diskutuar koha më e përshtatshme për zgjedhje. “Ky është një rast i rrallë ku të gjitha partitë pajtohen që të shkojnë

Konjufca thotë se raportet e Kosovës me Selinë e Shenjtë kanë qenë gjithmonë miqësore

PRISHTINË, 29 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim delegatin Apostolik të Vatikanit, Imzot Jean Marie Speich.

Në takim Konjufca ka shprehur vlerësimin e tij për avancimin e marrëdhënieve mes Vatikanit dhe Kosovës, tashmë edhe me themelimin zyrtar të Misionit të Veçantë të Republikës së Kosovës në Selinë e Shenjtë. Konjufca shprehur bindjen se

raportet e Kosovës me Selinë e Shenjtë kanë qenë gjithmonë miqësore dhe ato duhet të shkojnë drejt njohjes reciproke si shtete.

Po ashtu, kryekuvendari shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e tij për Papa Françeskun II për mbështetjen e tij ndaj komunitetit katolik në veçanti, por edhe mbarë popullit të Kosovës në përgjithësi.

Të dyja palët shprehën

konsideratën mbi kulturën e veçantë të tolerancës dhe vëllazërisë që ekziston te shqiptarët e të gjitha besimeve fetare.

Konjufca ka theksuar gatishmërinë e Kuvendit të Kosovës për t’i miratuar plotësimet dhe ndryshimet në Ligjin për Liritë Fetare, të cilat tashmë janë përgatitur, por votimi i tyre është bllokuar nga bojkoti i deputetëve të Listës Srpska në Kuvendin e Kosovës.



Maqedonci kërkon mbështetjen e Italisë për anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO

Prishtinë, 29 mars - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, me ceremoni zyrtare, të shoqëruar nga togu ceremonial i FSK-së, ka pritur të premtën në takim homologun nga Italia, ministrin Guido Crosetto. Në këtë takim miqësor është biseduar rreth situatës së sigurisë në vend, si dhe përformat se si mund të zgjerohet bashkëpunimi në fushën e shkollimit si dhe trajnimit të ushtarakëve, po ashtu në fushën e

industrisë së mbrojtjes. Me këtë rast, ministri Maqedonci ka kërkuar mbështetjen e Italisë në proceset për anëtarësimin e Kosovës në BE dhe në NATO, ku ministri Crosetto ka konfirmuar mbështetjen e pakursyer të Italisë. Të dy u pajtuan se Integrimi i Ballkanit në BE dhe në NATO do të krijonte stabilitet dhe paqe të qëndrueshme. Ministri Maqedonci e ka falënderuar homologun e tij për

mbështetjen që Italia i ka ofruar Kosovës, veçanërisht në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke qenë shteti me pjesëmarrjen më të madhe të trupave në kuadër të misionit të KFOR-it. Po ashtu, delegacioni italian është njoftuar rreth mbështetjes që Kosova është duke i ofruar Ukrainës përmes ofrimit të trajnimeve dhe dhurimit të automjeteve taktike e predhave që pritet të dërgohen së shpejti.



Pjesë e këtij takimi kanë qenë edhe zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, drejtori i Drejtorisë për Inteligjencë dhe

Siguri, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së.

MSh-ja shënon përparim 81% në menaxhimin e financave dhe integritetin institucional



PRISHTINË, 29 MARS - Në kuadër të projektit të mbështetur nga USAID/KMI për rritjen e performancës në menaxhimin e financave publike, auditimit të brendshëm, prokurimit dhe integritetit institucional, Ministria e Shëndetësisë është monitoruar nga ekipi i ekspertëve të USAID/KMI gjatë vitit 2022 dhe

2023, ku janë paraqitur edhe rezultatet e performancës për vitin e kaluar. "Bazuar në prezantimin e rezultateve nga USAID/KMI, rezultojnë se Ministria e Shëndetësisë ka shënuar një progres të shkëlqyeshëm prej 81%, që paraqet nivelin më të lartë të performancës për Menaxhimin e Financave dhe Integritetin

Institucional dhe se Ministria e Shëndetësisë është institucioni me performancën më të lartë nga të gjitha institucionet e monitoruara nga ky projekt", ka njoftuar MSh-ja. Sipas njoftimit, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka vlerësuar punën dhe angazhimin e stafit të administratës në adresimin e çështjeve të paraqitura nga viti i

kaluar, si dhe mbështetjen dhe gatishmërinë institucionale të projektit të USAID/KMI. Më tutje, ai theksoi përkushtimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të punuar në bazë të parimeve të llogaridhënies dhe transparencës, duke u shërbyer qytetarëve, sidomos pacientëve dhe njerëzve në nevojë.

Ndërsa drejtoresha e Projektit të USAID/KMI, Maia Gondolaze, ka shprehur kënaqësinë për të arriturat e ministrisë, duke shprehur besimin e saj se Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë të shënojë përparim në fushën e menaxhimit të financave publike dhe në fushat e tjera edhe në vitet e ardhshme.

Kurti mori pjesë në ekspozitën e botimeve të huaja për Kosovën, "Kosova në gjuhët e botës"

PRISHTINË, 29 MARS - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, mori pjesë në ekspozitën e botimeve të huaja të huaja për Kosovën të titulluar "Kosova në gjuhët e botës". Kjo ekspozitë është hapur për publikun më 25 mars dhe është organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Si një ndër aktivitetet e AShAK-ut për shënimin e 25-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s, kryeministri Kurti u njoftua nga kryetari i Akademisë, Mehmet Kraja, për llojlojshmërinë e tematikave të qindra librave dhe botimeve në shumë gjuhë të huaja, të cilat, përveçse pasqyrojnë ndërhyrjen e NATO-s, përfshijnë edhe mbështetjen ndërkombëtare ndaj Kosovës, si

dhe pjesë të historisë së popullit tonë në kohë lufte.

Me këtë rast, kryeministri gjatë bashkëbisedimit përmendi edhe botime nga autorë të huaj si studiues, gazetarë dhe publicistë, të cilët përmes shkrimeve e botimeve të ndryshme kanë sensibilizuar personalitetet me ndikim të botës demokratike rreth situatës në Kosovë gjatë viteve '90, me fokus intervenimin e suksesshëm të Aleancës Veriatlantike - NATO-s.

Në këtë aktivitet kryeministri Kurti u prit nga kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja, nënkryetarja Justina Shiroka - Pula, sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës së AShAK-ut, Fetah Podvorica, dhe sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, Gjyljeta Mushkolaj.



Opozita duhet t'i refuzojë zgjedhjet e parakohshme në Kosovë



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Lojë e "ndershme" nga lojtarë të pandershëm: Opozita në Kosovë ka kohë që ka kërkuar zgjedhje të parakohshme në Kosovë ndonëse, jo që nuk i ka numrat për ta rrëzuar qeverinë Kurti 2 por, përkundrazi, nuk e ka bërë asnjë veprim opozitar të mençur që do të ndihmonte në realizimin e kësaj kërkesë krejtësisht të natyrshme opozitare. Në anën tjetër, asnjë qeveri në Kosovë nuk ka qenë në situatë, shkaku i numrave, të ndihet më rehat se kjo e Kurtit 2, duke bërë çka ka dashur pa qenë e detyruar t'i japë llogari askujt. Kjo qeveri nuk ka lënë parim pa shkelur, standard demokratik pa dhunuar, vlerë kombëtare, politike, morale a kombëtare pa sulmuar apo pa njollosur sikur që nuk ka lënë figurë antikombëtare, pa asnjë vlerë morale, politike pa rehabilituar, në emër të patriotizmit të rremë, luftimit të korrupsionit për të vjedhur vetë masivisht dhe mbrojtjes së "parimeve" të proklamuar, për t'i mos i qëndruar besnik asnjë parimi. Albin Kurti e ka pasur mundësinë e madhe dhe të artë për të bërë ndryshime të nevojshme dhe të domosdoshme për Kosovën,

shqiptarët dhe qytetarët e saj. Jo që nuk i ka bërë këto ndryshime por i ka dëmtuar pariparueshëm shumë procese, mos të them të gjitha, si asnjë udhëheqës para tij. Bashkimi kombëtar i është vendosur sorrës ndër bisht, flamuri kombëtar është shndërruar në kondom të shqyer nga është ngjizur "flamuri i Kosovapetroilit" para të cilit përulen, për një copë pushtet dhe mundësi për të vjedhur pa rrezik për t'u dënuar si dhe për të punësuar kë të dojë (familjarë apo bashkëpartiakë), "xhovanifalkonet", pa tru dhe të tredhur të shpurës së Albinit. Albini para se të vinte në pushtet me 51 për qind të votave e perfeksionoi teorinë e Nikola Pashiqit ku, rrena për serbin dhe Serbinë është virtut dhe detyrim patriotik. Lexoni deklaratat, paraqitjet, premtimet dhe qëndrimet publike të Besnik Bislimit, Vojsa Osmanit, Glauk bin Sherifit, Arbërie Nagavci, Rozeta Hajdarit, Donika Katran Shvarcit, Hajrulkah Çekistit, General Kaçketës, Faraonit të Pejës, Hysen Bagerit, Eci Peci - Pecit, Rivanoll Strujës, Nenad Raushiqit etj. etj., për t'u bindur

në "teorinë time konspirative ...".

Oferta mjegull e KM Kurtit për zgjedhje, grackë për opozitën: Albin Kurti tash është në pozitën e Mbretit lakuriq në përrallat e Andersonit. Manastiri i Deçanit ia ka lakuriqar fytyrën politike. Dinari i Serbisë ia ka zhveshur brekushet ndonëse është edhe një seancë në Bruksel, sa për sy dhe faqe. Në takimin e parë është përfunduar puna. Është ndaluar shpronësimi i tokave në veri sepse kjo ishte vërejtje e ndërkombëtarëve. Gjeneral Kaçketa e ka harruar gjeografinë e veriut nga kërcënimi i listave të zeza, bashkë me Faraonin e Pejës dhe disa sekserë të kabinetit. Tre "musketjerët" e mjerë dhe grykës të pushtetit ia kënduan këngën "Besa - besë, besën ta kem dhënë .. se Zajebnicën do ta bajmë" Dora d'Bakojanis. Pas kësaj do të ketë kërkesa tjera nga BE-ja sepse me Marrëveshjen e Brukselit dhe bishtin e Ohrit statusi i Kosovës nuk paragjykohet, Kisha është pjesë e Serbisë në Kosovë, Rezoluta 1244 aktualizohet etj. Në këtë situatë Kurtit i duhen zgjedhjet si mundësi shpëtimi, Prandaj,

përmes zgjedhjeve përipiqet të blejë kohë dhe ta bëjë përgjegjës të përbashkët ndonëse askënd nuk e ka pyetur për asnjë vendim që e ka marrë. AAK-ja u ngut për mocion pas së cilës radiolidhja e Radojciqit në Kosovë, Limoza Kulari tha se: "VV nuk ka vota për opozitën për rrëzim të Kurtit...". Më habiti pse PDK-ja me një shpejtësi të pakuptueshme dhe të pabesueshme premtoi nënshkrimet që i duhen Kurtit për të shkuar në zgjedhje të parakohshme. LDK-ja mbajti një qëndrim, së paku publikisht më opozitar; kërkoi dorëheqjen e Kurtit për të shkuar në zgjedhje e që Kurti nuk e bën dot nga frika se ndërkombëtarët mund ta formojnë një qeveri me një kryeministër tjetër. Për mendimin tim edhe nëse opozitës i krijohet mundësia ta rrëzojnë qeverinë Kurti 2, nuk duhet ta bëjnë këtë, duhet ta lënë deri në fund të mandatit. Po ta kishin rrëzuar më herët, do të kishte një logjikë kurse tani Kurti këtë edhe e do, për të shpëtuar nga vendimet katastrofale dhe antikombëtare që i ka marrë. Nëse shkohet në zgjedhje Kurti e tejkalon rrezikun duke bërë koalicion me LDK-në kurse Vojsa

Osmani do të përfitonte edhe një mandat presidencial. Në këto rrethana Kosova, jo që nuk do të largohej nga Serbia por do të hynte në një vartësi federale apo konfederale me këtë shtet. Opozitës nuk i duhet që Kurtin ta luftojnë me Eskobarin, Blinkenin, Borrellin apo Lajçakun por duhet ta luftojnë me një opozitarizëm më agresiv, me një program zhvillimor që mund të realizohet, me një arsim pa analfabeten Nagavci, me një shëndetësi pa mashtruesin Vitinja, pa Gjeneral Kaçketën dhe të ngjashëm. Nëse luajnë në kartën se Kurti na prishi me amerikanë dhe ndërkombëtarë, opozita do ta këndojë "Këngën e Mjellmës duke ikur për lesh...". Opozita nuk duhet ta përkrahë mocionin për shpërndarje të Kuvendit sepse e fuqizon Kurtin. Nuk duhet në asnjë mënyrë të votojë marrëveshjet ndërkombëtare në pako sepse ia mbushin armën pozitës për fushatë. Edhe nëse rrëzohet qeveria, asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të shfuqizohet. Le ta përfundojnë këtë proces trojka që besnikërisht punuan dhe po punojnë kundër Kosovës dhe shqiptarëve.

Studentët e UP-së hyjnë në top treshen e garës më prestigjioze të drejtësisë në botë

Prishtinë, 29 mars - Studentët e Fakultetit Juridik të UP-së, të cilët përfaqësuan Universitetin e Prishtinës në garën "Willem C. Vis International Commercial

Arbitration Moot", arritën të dilnin në treshen më të mirë në botë. Kjo është gara më e madhe botërore në fushën e të drejtës ndërkombëtare komerciale

dhe arbitrazhit dhe kjo arritje e ngre lart punën e studentëve tanë dhe emrin e Universitetit të Prishtinës, si dhe na bën të gjithëve shumë krenarë. Në të kanë marrë pjesë

studentët Ariana Rexha Dea Feti, Morea Pula, Melisë Sejdiu, Nol Musa, Rea Hadri, si dhe trajnerët prof. Donikë Qerimi, Ilir Hajraj dhe Art Sylaj.



Kosova dhe Mali i Zi nënshkruajnë marrëveshjen e programit ndërkufitar IPA III, përfitojnë mbi 8 milionë euro

PRISHTINË, 29 MARS - Republika e Kosovës dhe Mali i Zi kanë nënshkruar të premtën marrëveshjen dypalëshe për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III për vitet 2021-2027. Marrëveshja është nënshkruar nga zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ministrja

për Çështje Evropiane të Malit të Zi, Maida Gorçević. Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka thënë se nga kjo marrëveshje Kosova dhe Mali i Zi përfitojnë 8.4 milionë euro. "Ky bashkëpunim do të avancohet dukshëm duke u kujdesur për zbatim të plotë të marrëveshjes. Marrëveshja u mundëson Kosovës dhe Malit të Zi të përfitojnë 8.4

milionë euro dhe ka për qëllim promovimin e fqinjësisë së mirë, zhvillimin social dhe ekonomik. Është planifikuar themelimi i një task-force të përbashkët e cila do ta mbikëqyrë zbatimin e programit. Kjo marrëveshje i kontribuon bashkëpunimit të mirë mes dy vendeve", ka thënë Bislimi.



Statistikat e infrastrukturës, Kurti: Do t'i përfundojmë punët që qeveritë e mëhershme i lanë keq e në gjysmë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka paraqitur në "Facebook" të premtën statistikave në zhvillimin e infrastrukturës. Ai ka thënë se për ekonomi të shëndoshë e zhvillim të qëndrueshëm infrastruktura është element kyç. "Jo vetëm në ndërlidhjen më të shpejtë e të afërt ndërmjet qyteteve së brendshme, por edhe në lehtësimin e qasjes në rrugë e bashkëpunim rajonal. Po, do t'i përfundojmë punët që qeveritë e mëhershme i lanë keq e në gjysmë, si rruga Prishtinë - Podujevë, Prishtinë - Mitrovicë, autostrada Prishtinë - Gjilan dhe rruga Prishtinë - Pejë. Nuk ka qenë e lehtë ta zhbëjmë labirintin burokratik, keqplanifikimet me projekte dhe keqmenaxhimet me kontrata, por po ia dalim", ka thënë ai. Kurti ka theksuar se tashmë kanë filluar punimet me hov të merituar në rrugën Prishtinë - Mitrovicë. Sipas tij, puna në segmentin e parë të kësaj rruge kishte nisur në vitin 2009, para 15 vjetëve. "Nga një rrugë e cila ishte me dy korsi, po e kthejmë atë në rrugë nacionale me dy drejtime, me gjithsej katër korsi. Puna po vazhdon edhe në rrugën Prishtinë - Podujevë, e cila ka filluar të ndërtohet në vitin 2016, para tetë vjetëve. Atë po e zgjerojmë dhe po ia shtojmë të shumëpëriturat 15 kilometrat e



mбетur në segmentin Prishtinë - Lluzhan, për çka kemi ndarë 35 milionë euro", ka bërë me dije kryeministri. Ai ka shtuar se autostrada Prishtinë - Gjilan po shkon drejt përfundimit. "Mbi 75 % të punimeve deri në fshatin Bresalc janë finalizuar. Është ndarë

buxheti për vazhdimin e saj deri te Dheu i Bardhë. Jemi të vetëdijshëm për vonesat, por edhe jemi të vendosur që puna të ecë e të përfundojë me cilësinë e duhur dhe sa më parë. Ndërkaq tash së fundmi janë nënshkruar kontratat për fillimin e ndërtimit të rrugës me katër korsi Prishtinë

- Pejë, segmenti Kijevë - Dollç, me një gjatësi 12.8 km, në vlerë prej 21 milionë eurosh. E kemi ndarë buxhetin për të vazhduar pastaj me segmentin nga Dollci e deri në Zahaq", është shprehur Kurti. Më tej, ka treguar se kanë filluar procedurën e prokurimit për

ndërtimin e rrugës nga dalja jug e autostradës në Prizren e deri në hyrje të tunelit të rrugës Prizren - Tetovë si dhe ndërtimin e rrugës nga fshati Kërstec në komunën e Sharrit e deri në fshatin Zapod të Bashkisë së Kukësit. "Jemi afër përfundimit të urës në Drelaj dhe janë nënshkruar kontratat për ndërtimin e urave në Badoc dhe Rogovë të Hasit. Ndërtuam e asfaltuam rrugë edhe në zona e fshatra në veri të Republikës me të cilat lidhëm fshatrat mes vete si dhe me komuna në jug. Atje, po ashtu, për herë të parë po ndërtojmë e rinovojmë dhjetëra shtëpi të banorëve shqiptarë që janë dëmtuar nga lufta e fundit në Kosovë. E pas 24 vjetëve në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Laposaviq hapëm e funksionalizuar Zyrat Kadastrale Komunale. Të gjitha këto janë bërë, ndërkohë që borxhin për shpronësime e kemi ulur për 86 milionë euro", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se shtrimi i rrugëve është i rëndësishëm aq sa mirëmbajtja e tyre. "Më herët mirëmbajtja e rrugëve ka kushtuar 57 milionë euro për tri vjet. Tani, me kontratat që kemi nënshkruar ne, me paramasa të ndryshuara, duke shtuar pozicione që e rritin kualitetin e sanimeve siç janë rrjetat geogride në shtresa të asfaltit dhe duke hequr pozicionet fiktive dhe ato të duplikuara, e kemi zbritur atë në 38 milionë euro", ka thënë kryeministri Kurti.

Murati thotë se qarkullimi i bizneseve për muajt janar dhe shkurt ka shënuar rritje, i reagon opozita

PRISHTINË, 29 MARS - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se qarkullimi i bizneseve për muajt janar dhe shkurt të këtij viti, krahasuar me vitin 2023, shënon +4.8% rritje. "Këto janë të dhënat zyrtare të deklaruara në ATK. Çdo pretendim tjetër nëpër studio televizive ose është i keqinformuar, ose qëllimkeq. Ndërmarrësit tanë e bizneset tona kanë dëshmuar tash e sa kohë që u bëjnë ballë të gjitha sfidave", ka shkruar Murati në "Facebook".

Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka reaguar ndaj kësaj deklarate të Muratit, duke thënë se eksportet e Kosovës të vitit 2023 janë për 6% më të ulëta se ato të vitit 2022. "Për këtë s'po flet a?", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Ajo e ka pyetur Muratin se çfarë ka bërë si ministër për sektorin privat. "Çka ke bërë ministër për sektorin privat që po krenohesh me qarkullimin e tyre, përveç që ju ke marrë taksat dhe i ke shpërnda në formë të karamelleve. Në mandatin e juaj



investimet kapitale të nivelit qendror janë të njëjta me ato të

vitet 2017, plus ti ke inflacion 23% në tri vitet e fundit,

bizneseve u është dyfishuar tatimi në pronë, bizneseve u është rritur çmimi i energjisë, bizneset për shkak të sanksioneve që ju e keni futë vendin e kanë pasur shumë më vështirë t'i mirëmbajnë kontratat me partnerët e tyre jashtë dhe për atë arsye eksporti në vitin 2023 është për 6% me ulët se ai i vitit 2022. Që dy vjet e ke drejtorin e ATK-së pa mandat, të emëruarin e PDK-së në kohën e Bedri Hamzës ministër i Financave, çka me të thanë", ka shkruar Bajrami.

Humnerat dhe majat e shpirtit ishullor në “Enciklopedinë imagjinare” të Bajram Kosumit

Vështrim eseistik për librin e Bajram Kosumit, “Enciklopedia imagjinare, postroman”, Toena, Tiranë, 2023



Nga Ismail SYLA

NË VEND TË HYRJES

Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe ekziston fjala çanësim, për fjalën përkufizim, definicion. Nëse do ta çanësoja librin e Bajram Kosumit me një titull të ri atëherë do të thosha “Bibla e Kosumit, ngase, sipas mendimit tim “Enciklopedia imagjinare” është projekt pretendues bibliik. Nëse do t'i përgjigjeshe një pyetjeje klike të anketës se cilin libër të vetëm do ta merrje në një ishull a planet, pa mëdyshje nga letërsia shqipe do ta merrja “Enciklopedinë”.

Nëse ndodh kataklizmi, ose ai akti i tipit barabar të djegies së bibliotekës së Aleksandrisë, në mesin e një krah librash për veten time do ta shpëtoja edhe “Enciklopedinë imagjinare” të Kosumit.

Nëse do të zhbëhej etnografia dhe etnologjia, letërsia shqiptare, them se mjafton të shpëtojë “Enciklopedia”.

Nëse në romanin “Kronikë në gurë” ku gjithë qyteti është i bërë prej pllakave të gurit, themelet, muret, kulmet, Kadare na jep mishin e butë të jetës, në “Enciklopedi” frymon qenia shqiptare e Kosovës, fytyra e përjetshme e njeriut të saj në të gjitha përmasat jetësore dhe historike: ekzistenca e tij, robëria, qëndresa, lufta për liri, por edhe marrëzia, kotësia, paradoksi dhe të gjitha trajtat e shpërfaqjes së karakterit dhe psikologjisë së tij. Në këtë vështrim eseistik preken tema dhe motive vetëm të 13 tregimeve, ndërkaq “Enciklopedia” na ofron motive dhe ide pafund.

DY HUMNERA DHE NJË NDËSHKIM KOSUMIAN

1. Kolonizimi dhe tjetërsimi i tokave shqiptare

Idenë e dështimit të projekteve serbomëdha të të gjitha kohëve

autori B. Kosumi e jep përmes tregimit “Koloni serb i shekujve XIX-XX”.

Përmes fatit tragjik të brezave të familjes së Vasojeviqëve, një fis malazez, jepet fundi katastrofik i ëndrrës së “popullit qiellor” që pretendoi të kolonizojë toka të huaja, të Kosovës, Vojvodinës, Peshterit, Maqedonisë dhe të Kroacisë.

Atë që e fiton me pushkë, për herë të parë, pra shtëpinë, mullirin dhe kumbulloren e përmendur të një shqiptari në Prokupje (ligjërim vërtet epik i Kosumit: me pushkë), dhe më tutje shtëpi, ara, kopshtije, e toka të tjera në Vojvodinë, në Llap, e deri edhe në kufirin me Shqipërinë, në Jasiq, brez pas brezi, vjen koha kur i humbin radhazi.

Në fund, epilogu i Vasojeviqadës, i sagës së tyre, i atyre që u përdorën si marioneta, herë si kriminelë e herë si viktima, për të realizuar projektin e Serbisë së Madhe, është një fat tragjik: jo më një shtëpi, por as për varr nuk e kanë një vend.

Kështu, postulatit e njohur se një popull që robëron një tjetër komb ose popull, në njëfarë mënyre e robëron vetveten, që është frazë proverbiale, Bajram Kosumi e zhvillon në këtë tregim duke vënë pah dy anë të medaljes, çmitizimin e konceptit serb se Kosova është zemër e Serbisë, nga njëra anë dhe të vërtetën nga ana tjetër që Kosova ishte edhe ferr i Serbisë.

2. Asgjësimi kulturor, zhbërja e trashëgimisë dhe historisë

Një ideologji tjetër e zhbërjes ishullore (ballkanase dhe më gjerë) paraqitet në tregimin “Arkitektura midis luftërave” përmes kompanisë urbane greke “Fardis Company”, e udhëhequr nga Nikollas Fardis, gazetar dhe politikan me ide kulturocide. Fardistët janë personifikimi i kompanisë e cila kryen punë praktike për secilën politikë apo

keqes, si dukuri morale, por nënshtruar me ligjet e estetikës.

NJË MAJE SUBLIME E KULTURËS SHQIPTARE

Si antipod i këtij modeli kulturë-vrasës në “Enciklopedi” qëndron tregimi “Kodiku i Purpurt i Beratit”. Tregim me rrjedhë kristali. Tregim homazh dhe monumental për dashurinë dhe përkushtimin e shqiptarit për kulturën, formën më sublime të shoqërisë njerëzore.

Banorët e Beratit, në radhë të parë udhëheqësit dhe priftërinjtë me zemër të fortë, moral të lartë dhe besim të pastër, me shekuj ruajtën Kodikun e Purpurt të Beratit, shkruar me dorën e Shën Gjon Gojartit apo Gojëmjalit, si e kanë quajtur. Pati shumë fushata të huaja e të brendshme për të rrëmbyer Kodikun, shumë luftëra, ekzekutime, kontrole e rrënime të varreve e të kishave, por Kodiku u ruajt në duart e beratasve për shekuj me radhë.

Si në një film, autori përshkruan sprovat e këtyre heronjve të kulturës. Ata dhe me dorën mbi Bibël thonë të pavërtetën, duke e ditur se ajo e pavërtetë pranohet nga zoti, ngjashëm, por në kontekst tjetër, me deklaratën e famshme të Galileut për Tokën, që nuk sillet rreth Diellit – thënë publikisht, - E, megjithatë, sillet, – thënë me zërin e brendshëm.

Përmes tregimit për “Kodikun...” Bajram Kosumi e ngre lart, në

mision historik e filozofik, vetëdijen iluministe shqiptare për kulturën. Kjo është një nga majat në këtë “Enciklopedi”.

FYTYRA DHE NATYRA E DIKTATURËS DHE DHUNËS

Në pafundësinë e temave dhe motiveve që përmban “Enciklopedia imagjinare” vend të rëndësishëm me prurje estetike dhe teorike janë tregimet të “Libri për pesë Mariet”. Ky është korpusi i pesë tregimeve për fatin e gruas në shekullin XX.

Tri Marie kanë lidhje të drejtpërdrejta me natyrën dhe fytyrën e diktaturës. Marie Shllaku me diktaturën serbe komuniste në fund të luftës së Dytë Botërore, kur Kosovës iu vazhdua pushtimi, Marie Kokollari me diktaturën shqiptare, Marie Jorgiqi, serbe, shembulli më unik i urrejtes dhe luftës së klasave, kur digjet e gjallë me foshnjën në bark nga komunistët serbë më 1948. Ndërkaq dy Mariet tjera, këngëtarja dhe gruaja e të burgosurit politik, janë viktima të një forme tjetër të diktaturës, epja pas gjenisë muzikore - Marie Krasniqi, dhe vuajtjet epike të Marie K, e cila me besnikëri dhe sakrificë përballon, jo veç vuajtjet për burrin në burg, për demonstratat e vitit 1981, por edhe rropatjet me rrethin ku jeton.

Tregimet për tri Mariet, krahas librit “Jetë burgu” të Fatos

qeveri kulturocide. Kjo kompani vrau, rrënoi dhe asgjësoi trashëgiminë pesëqind vjeçare të perandorisë osmane në Athinë, 720 fshatra shqiptare të Toplicës (1878-1900) varrezat Hebreje në Selanik dhe projekte të tjera të ngjashme.


Kontratën e fundit kjo kompani e bëri me regjimin e Milosheviqit më 1999, për ndryshimin e arkitekturës së Kosovës pa shqiptarë, por që dështoi keq. Kosova nuk u zhbë. Shefi i krimeve serbe në Kosovë u burgos, ndërsa pronari i kompanisë u vra në një atentat në Prishtinë.

3. Ndëshkimi estetik

Derisa në “Kolonin serb...” Kosumi, në fund të tregimit, nuk e kursen epitetin “fisi trim” për Vasojeviqët, pra për kolonistin që merr shtëpitë e tokat e huaja dhunshëm, sipas parimit homerik se trojanët janë karaktere të forta po aq sa grekët, por, ai nuk i fal as mëshiron ideatorët, projektuesit, zbatuesit dhe përbindëshat e krimeve, vrasjeve dhe të gjenocidit, të personifikuar me kriminelin e luftës Radovan Karaxhiq, të cilin, veçan nga Gjykata e Hagës, narratori e ekzekuton metaforikisht në mënyrën më mizore në Paris, në një garë ndërkombëtare për zgjatjen e vdekjes, të tregimi “Panairi i zgjatjes së vdekjes”.

Në këtë tregim tema, motivet dhe personazhet globalizohen, ndërsa ligjërimi merr shprehësi të një raporti juridik. Aty vihen përballë dy kultura, perëndimore dhe ajo lindore, kristiane dhe ajo osmane, të cilat maten në mjeshtërinë e mbytjes së viktimizeve, duke ua zgjatur vdekjen dhe torturat: ai xhelat që e zgjatë më shumë vdekjen në tortura mizore, e merr kurorën e fituesit.

Ky tregim ka një ligjërim të kristaltë. Gjatë leximit nuk neveritesh dhe as pështrësosh, shenjë e zotërimit artistik të së



Lubonjës, janë ndër prozat më cilësore dhe më të arrira estetikisht në letërsinë shqipe me temën e burgut dhe motivin e vuajtjes dhe qëndresës.

Vuajtjet dhe përjetimet e jetës brenda mureve të burgut të Marie Kokollariit përkojnë me filozofinë dhe vrojtimit psikologjike të personazhit të Alber Kamysë, Mersosë, i cili pret ditët, orët dhe sekondat deri në çastin e shkuarjes nën gjotinë. Tërë kalvarin e burgut monoton, paradoksal dhe vrtast të modelit të diktaturës shqiptare, Kosumi e jep përmes mentronomit, instrumentit ndihmës të pianos, i cili mat kohën e ritmit muzikor, e në këtë tregim shndërrohet në simbol të matjes së çdo sekonde, simbol i përjetimit të vetëdijshëm të çdo çasti të burgut, pa u nënshtruar.

Klithma e Marie Jorgiqit, e dhunuar, e lidhur dhe në fund e ndezur me benzine, nga komunistët e Titos, është klithmë e dyfishtë e qenies njerëzore, sepse brenda trupit i digjet edhe foshnja, ndërkaq mizoria, sadizmi dhe natyra destruktive, barbare e ekzekutorëve është e pafund. Kjo mizori është shfryrë mbi një shekul mbi banorët e Gumurit kosumian, që në forma të ndryshme është shtjelluar në zëra të shumë në "Enciklopedi". Ndër prozat më të bukur të temës së diktaturës është ajo me titullin sinjifikativ "Kampi". Është metafora më e mirë për epilogun e diktaturës së Milosheviqit. Në muret e ndërtesës së komunës shkruhen inicialet K.R. (Kosova Republikë). Pason ngjyrosja, për ta fshirë, pastaj ajo shkruhet përsëri, përsëri fshihet, por vendosen edhe rrethoja, telat mbi rrethojë dhe në fund edhe rojet e armatosura rreth e rreth komunës. Sa herë shkruhet K.R., pason një rrethojë më e madhe. Kur lexuesi pret që dy nistorët e famshme, tmerruese për regjimin, të shkruhen nga dikush brenda, si shenjë e këmbëngulësisë së njeriut që kërkon lirinë, tregimi përfundon. Që të kuptohet ideja dhe porosia e tregimit, ndihmon poetika e kurthit të titullit:

Kampi" kampi". Komuna u bë kamp përqendrimi. Regjimi i Milosheviqit Kosovën nuk arriti ta nënshtronte edhe kur e bëri kamp përqendrimi, përkundrazi. Në këtë pikë, Kosova këputi prangat. Ato zunë vend në duart e diktatorit serb.

FARKIMI I REZISTENCËS

Një ndër motivet bazike të Enciklopedisë është ai i farkimit të qëndresës së heroit shqiptar, të njeriut shqiptar. Ndër më të realizuarit, sipas mendimi tim janë tregimet "Gjuha dhe krimi", "Beqa i Shahiqëve", "Marie K."

Në tregimin e parë del në shesh vendosmëria e të burgosurit politik, personazh real jetësor, Isa Demaj, i cili refuzon të flas serbisht me anëtarët e familjes, gjatë vizitave në një burg në Serbi. Dhe, kjo zgjatë pesë vjet. Edhe dhuna, edhe dënimi, edhe burgu i heroit shqiptar flet serbisht. Edhe ai flet me ta serbisht. Por, jo me familjen e tij.

Ai është i gatshëm të debatojë pafundësisht në këtë gjuhë me administratorët serbë, lexon libra në këtë gjuhë, por ka një mur të patejkalueshëm: nuk mund ta thërras nënën "Nënë" në gjuhën që vetë atë e burgos dhe popullin e tij e mban në burgun qindvjeçar të robërisë.

Po aq motiv kundërshtimi, ku mprehet dhe farkohet ideja e qëndresës, gjendet të personazhi tjetër, një njeri fare i rëndomtë, Beqa i Shahiqëve, që në kohën e dëbimit, zbuarjes së shqiptarëve nga institucionet pas 3 shtatorit 1990, hap një çajtoje, në të cilën punon pa fitim. Nuk është esencial përfitimi. Aty tubohet elita e ekskomunikuar shqiptare. Aty mbahet dhe qëndron i panënshtuar njeriu i Kosovës.


Autori e mbyll tregimin me sa ironi, aq edhe me sarkazëm, me sa grotesk, aq me heroizëm të njeriut të rëndomtë, por të ndershëm në çdo qelizë: në Kosovën e lirë, kur festohet njëvjetori i çlirimit Beqa mbetet po ai, njeri i zakonshëm dhe në fund të stadiumit ku mbahej manifestimi. Atij nuk ia sigurojnë një ulëse te pjesa e kontribuuesve të lirisë. Askush nuk e llogaritë kontributin e tij me çajtojen.

Ama autori nuk i hyn në hak. Dhe ka të drejtë: pa dyshim, ndër të parët meritore do ta kishte vendin edhe Beqa i Shahiqëve, njeriu bazë, humusi i kombit, i cili në çajtojen e tij të mjerueshme tuboi për disa vjet elitën e çekuilibruar të Ishullit.

Maria e Pestë, Marie K. është figura monumentale e gruas së të burgosurit politik. Kushdo nga gratë e kësaj kategorie sociale e lexon këtë tregim e gjen vetveten aty. E gjej unë aty nënën time, motrat e mia, i gjej familjet e ish të burgosurve politikë. Në kulmin e bojkotimit, në kulmin e ashpërsimit të qëndrimeve të pushtetit jugosllav dhe serb ndaj të burgosurve që prishën mitin e vëllazërimit bashkimit dhe të parajsës socialiste, mbi gratë dhe familjen binte barra e rëndë e pasojave. Izolimi, leçitja, ballafaqimi me karakteret labile dhe të frikësuar përreth, identifikimi me stigmën "armi i të popullit", për gratë e të burgosurve dhe familjet e tyre ishin sprova që përgjithësisht u përballuan me sukses.

Familja si bërthamë e shëndoshë ishte forcë morale për të burgosurit politikë. Ky është besimi i patundur, thuajse i verbër, thuajse mitik, në vizionin e lirisë, edhe atëherë kur ajo as nuk dukej gjekundi. Në letrën 82/90 (fq. 610) gjejmë një motiv të këtij besimi mitik: kur fqinja pro-pushtet e pyet Nënë Shahë, e cila ka dy djem në burg për Republikën, se si i ke djemtë, ajo i përgjigjet: "Si rrezja! Tha edhe zoti ka me ju ndihmue, e kanë me dalë faqebardhë për atë punë për çka janë në burg."

Jeta e Marie K., pas burgosjes së burrit të saj, Albanit, në vitin 1981, përkushtimi i saj për burrin e burgosur, personalizimi i vajzës së tyre të sapolindur pas burgosjes, Liridonës; betimi i Mjellmes se nuk do të qesh më kurrë në jetë, pas vrasjes së vëllait të saj në demonstratat e atij viti;



kënga dasmore në shtëpinë e Nënës Naile, në të cilën motrat i këndojnë vëllait të burgosur, Latës, i dënuar me shtatë vjet burg, dhe pritjes po aq vjet të të fejuarës, Mirvetit, të gjitha këto janë elemente të zakonshme, të përditshme, por thelbësore dhe monumentale, në të cilat farkohet liria dhe rezistenca shqiptare për liri.

RRJETA E RRJETËZUAR E NARRACIONIT OSE POETIKA E FUSNOTËS FERTILE

Në tregimin "Panairi i zgjatjes së vdekjes në Paris" autori I intertekstualizon dy libra të tjerë: personazhin e Robert Francois Minot nga Mishel Fuko-s, te Lindja e burgut/disiplinës dhe ndëshkimit, dhe Ura mbi Drinë të Ivo Andriqit, të cilin, në fund, e ironizon në Fusnotën 3, si mjeshtër më i mirë në përshkrimin e dhunës çnjerëzore.

Për të kuptuar më mirë mjeshtërinë e veçantë krijuese të Kosumit në Enciklopedi, mund të na shërbejë si model ky tregim. Deri sa në përshkrimin e torturave të kampit osman ai intertekstualizon ironikisht Ivo Andriqin, në përshkrimin e torturave të kampit evropian, intertekstualizohet po ironikisht një burim francez, në Fusnotën 2, në të cilën thotë: "Bëra një përshkrim më të shkurtër të garës së xhelatit francez, sepse më mirë se unë e ka bërë gazeta franceze Gazzete d'Amsterdam, të datës 1 prill 1757, në rastin e ekzekutimit publik të Robert Francois Deminit."

Për më tepër, Fusnota 1 na dëshmon një mjeshtri krijuese të Kosumit: futjen e temave të reja në një tregim, si fusnotë, si

ndajshtesë, por në fakt, këto tema fusnotë janë pasqyrë e lajtmotivit të tregimit. Shpeshherë këto tregime të fusnotave janë më të bukura se vetë tregimi ku bashkëngjiten. Në Fusnotën 1 të këtij tregimi rrefehet prapavija e një atentati të mundshëm ndaj Luigjit XV nga një grup i shqiptarëve, nën kujdesin e kryepeshkopit të Shkupit Mëhill Suma.

Në fakt, motivi themelor nuk është ky, por një tekst i intertekstualizuar i Francoise Casanova-s, në të cilin pëshkruhet detajisht ekzekutimi publik i Francoise Damiones. Burrat shqiptarë, me mendësi ishullore pak të marrë e pak heroik, nuk mund të pajtohen se edhe në Perëndim ka asi mbretër çnjerëzor, të cilët bëjnë ekzekutime publike aq mizore, prandaj vendosin ta vrasin Luigjin XV.

Ky është modeli i rrefimit i Kosumit, në të cilin krijohet rrjeta e ngjarjeve dhe e personazheve, e cila rrjetë ka vjeggëza të shumta që mbajnë varur rrefime, personazhe e ide nga ngjarje të tjera, epoka të tjera, kultura të tjera, por të gjitha fuzionohen rreth një ideje qendrore të tregimit.

MOTIVE TË PAFUND

Në Enciklopedi ka qindra motive të cilat mua më japin shkas për interpretim eseistik, një zhanër që e kultivoj me kënaqësi. P.sh. titulli i tregimit "Sytë e Adem Jashari" për mua ka vlerë aq sa sintagmat e mirënjohura botërisht "Prekja e Zotit", "Kryqi i Kreshtit", "Guri i Sizifit", "Kompleksi i Edipit" etj. Nuk ka perde më të fortë morale për të mos shkarë në gabime,

lajthitje, ligësi dhe devijime tjera joetike, se s kuptimi simbolik i syve të Adem Jasharit, të cilët nga fotoja në kornizën e varur në mur, me shikim fiktiv, i rri gati nëpunësit shtetëror të mos tundohet nga e keqja, se ja unë, flijuesi i madh i lirisë tënde po të shoh! Andaj. Mos, mos, mos. Mos abuzo, mos vidh, mos bëj krim.

Në "Enciklopedi" Kosumi trajton tema nga më të ndryshmet. Paradokset dhe marrëzitë ishullore-shqiptare janë koleksion i tërë. Që në krye të librit kemi tregimin "A u ribë Gurshtë": një ndër tregimet sa ironike aq edhe tragjike. Ky tregim sintetizon arsyen mijëvjeçare të shpirtit rob të shqiptarit. Ai që herët ka lënduar dhe thyer dhe asgjësuar të shenjtën e tij, E nis i marri, pas tij elitari i shpifur.

Pasardhësit besnikë të atij të marri që provoi se mund t'i hiqet një copë gurit të shenjtë, sot janë ata që e rrahin shuplakë Gjergj Kastriotin, ata që përdhosin çdo kryeverë kombëtare, njësinë e gjuhës, gjenialitetin e Ismail Kadarese, qëndrestarinë e Adem Demaçit etj.

Në "Enciklopedi" ka pafund motive të përjetshme, me të cilat nuk rreshet së ballafaquari mendja njerëzore, njëjtësimi me Zotin, përmes artit dhe dashurisë, lufta e përjetshme midis ekzistencës materiale dhe të bukurës (Kali), midis mendjes dhe ndjenjës, konflikti i mendjes kontabiliste dhe shpirtit artistik.

Në "Enciklopedi" gjejmë motive ekstreme që nga interpretimet semiologjik "Gjuha dhe veprimi" deri te ato astrofizike "Mesazhi për fundin e botës" Në të parën autori interpreton shkëlqyeshëm përmes modelit sasior të fjalëve përsëritëse "tungjatjeta" dhe ndajshtimet e emrit të Ramadan Shabanit: Dan në shtëpi, Ramadan, në fshat, Ramadan Aga në rreth, Aga Ramadan Aga, në rrethë më të largëta dhe Aga Ramadan Beg Aga, në vende të panjohura. Mungon vetëm ndajshtim pezhorativ i grave, Ramadanagji.

Në njësinë apo zërin tjetër (i cili na bind se shkenca nuk është larg imagjinatës dhe e kundërta!) paraqitet fati i sistemeve diellore, i planetëve dhe i vetë njeriut e qenies njerëzore në kozmos.

Një motiv interesant është ai i verbërisë ideologjike të njeriut të ri në tregimin "Bunkerit 1224", ku pos groteskut ndërton teorinë e antievolucionit: njeriu i bindur e i nënshtruar merr tipare bishe, shkon drejt egërsisë. Është pasojë e diktaturës ideologjike.

PËRMBYLLJE

Bajram Kosumi dhe enciklopedisë së tij imagjinare i shkon për shtati ideja e dytë e Faustit të Gëtes. Mbretëria gjermane po të kapitullojë e të vihet në ankand, mund të blihet nga ndonjë mbretëri, por jo qyteti i krijuar nga Fausti në stere, në sipërfaqen e zënë në ujën e detit. "Enciklopedia imagjinare" është kryevepra e B. Kosumit, rrjedhimisht dhe pa dyshim, një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Inveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Nisën punimet për rindërtimin e fushës në stadiumin ‘Fadil Vokrri’

Prishtinë, 29 mars - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka njoftuar se kanë filluar punimet për rindërtimin e tërësishëm të fushës së stadiumit “Fadil

Vokrri” në Prishtinë. Ky investim është paraparë të jetë 1.3 milion euro dhe mendohet të kryhet në verë, për të qenë gati për ndeshjet ndërkombëtare të klubeve të

Kosovës. “Nisën punimet për rindërtimin e tërësishëm të fushës së stadiumit ‘Fadil Vokrri’. Me punë profesionale dhe pa humbur kohë stadiumi do të jetë i gatshëm

për ndeshje vendore dhe ndërkombëtare. Konsolidimi i infrastrukturës së futbollit në gjithë vendin është prioriteti ynë”, ka shkruar Çeku.



Ujkani: Do të jemi maksimalisht të përgatitur për Ligën e Kombeve

“Epoka e re”

PRISHTINË, 29 MARS - Zëvendësudrejtori i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Samir Ujkani, e ka vlerësuar grumbullimin e parë me përzgjedhësin Franco Foda si të suksesshëm. Ai beson se në qershor lojtarët do të përshtaten edhe më shumë me trajnerin

gjerman. Derisa në shtator, kur edhe fillon Liga e Kombeve, Ujkani është optimist se “dardanët” do të jenë të përgatitur maksimalisht. “Ja ka filluar një fazë e re me trajnerin e ri. Ka qenë një impakt pozitiv. Trajneri është lidhur shumë shpejt me lojtarët në mënyrë pozitive dhe i ka treguar të gjitha idetë e tij dhe mentalitetin që e dëshiron në fushë. Në qershor e kemi fazën ku

do të jemi të gjithë bashkë. E kemi rastin me u lidh sa ma mirë lojtarët me trajnerin. Kjo është me pas grupin sa më të fortë në shtator kur fillon Liga e Kombeve. Shpresojmë që secili lojtar të jetë në elementin më të mirë dhe të arrijmë qëllimin”, ka thënë Ujkani. Kosova në dy ndeshjet miqësore regjistroi një fitore ndaj Armenisë (1-0) dhe pësoi humbje nga Hungaria (2-0).



Futbolli rikthehet me ndeshje të zjarrta



“Epoka e re”

PRISHTINË, 29 MARS - Pas pushimit për shkak të ndeshjeve miqësore që i zhvilloi Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, Superliga e futbollit rikthehet me ndeshje të zjarrta në këtë fundjavë. Sot (e

shtunë) zhvillohen dy ndeshje të zjarrta. Skuadra e Prishtinës e pret në stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan, kampionen në fuqi Ballkanin. Kryeqytetasit do të mundohen të marrin pikët maksimale për tu ngritur në tabelë, e në anën tjetër Ballkani që është në garë të

reptë për titull me Llapin dhe Dritën. Kjo e fundit ka punë mjaftë të vështirë, pasi luan ndaj Malishevës që në ndeshjet e fundit po tregon formë të lartë dhe për skuadrat kryesuese po del të jetë “arrë” e fortë. Të dielën do të zhvillohet ndeshja mes Llapit dhe Lirisë. Llapjanët

presin tri pikë të reja në mënyrë që të presin në anën tjetër gabimet eventuale nga dy konkurrentet për titull. Të dielën luhen edhe dy përballjet tjera mes Feronikeli 74 dhe Fushë Kosovës dhe Gjilanit e Dukagjinit. Të gjitha ndeshjet nisin nga ora 15:00.

Federata e Boksit kërkon që boksierët të paraqiten me emblema të Kosovës në Beograd



Prishtinë, 29 mars - Përfaqësuesja e Kosovës në boks ka dorëzuar listën prej tetë boksierëve dhe një boksierje për Kampionatin Evropian për Seniorë. Evropiani i boksit do të zhvillohet në Beograd të Serbisë nga data 15 deri më 29 prill. Duke pasur parasysh problemet që në të kaluarën shteti serbi u ka shkaktuar sportistëve të Kosovës, Federata e Boksit të Kosovës (FboxK) ka marrë masa duke i dërguar letër zyrtare Federatës Ndërkombëtare të Boksit (IBA), së cilës i ka kërkuar mundësi të barabarta për të gjithë sportistët, si dhe të lejohet përfaqësimi i përfaqësueses me

uniforma dhe emblema të Kosovës. “Federata e Boksit më 29.02.2024 i ka dërguar letër zyrtare Federatës Ndërkombëtare IBA, Federatës Evropiane EUBC, Federatës së Boksit të Serbisë, ku ishin të informuar dhe Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit MKRS, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, ku FboxK-ja ka kërkuar të zbatohen masa dhe udhëzime strikte që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë sportistët, pavarësisht nga gjinia, kombësia apo çdo karakteristikë tjetër që mund të jetë bazë për diskriminim, të lejohet përfaqësimi i përfaqësueses me uniforma dhe

emblema të Republikës së Kosovës si të gjitha shtetet pjesëmarrëse”, thuhet në njoftimin FboxK-së.

Ekipi i Kosovës në boks:

1. Bashkim Bajoku (54 kg)
 2. Lorent Murati (60 kg)
 3. Shpëtim Bajoku (67 kg)
 4. Patriot Behrami (71 kg)
 5. Jozef Rrasi (75 kg)
 6. Taulant Jakupi (86 kg)
 7. Donat Sylja (92 kg)
 8. Shpejtim Shabani (+92 kg)
 9. Donjeta Sadiku (60 kg)
- Trajner: Musli Zymberi, Faton Xhaki dhe Marjola Sallauka.
 Gjyqtar: Latif Demolli

Sot tri ndeshje në Superligën e hendbollit

Ferizaj, 29 mars - Sot (e shtunë) nga ora 20:00 zhvillohen tri ndeshjet e xhiros së 23-të të Superligës së Kosovës në Hendboll (meshkujt). Kastrioti - Prishtina vlerësohet ndeshja më interesante e kësaj jave. Zhvillohet në palestrën “Bill

Clinton” në Ferizaj. Kastrioti është duke e gjetur ritmin e fitoreve dhe synon pikë të reja ndaj Prishtinës. Ndërkohë skuadra kryeqytetase synon të reagojë pas disa dështimeve rresht. Kastrioti është i treti me 28 pikë, ndërsa Prishtina e pesta

me 19. Lideri i klasifikimit, Rahoveci, llogarit në tjetër fitore. Luan në Gjakovë ndaj Vëllaznimit, por skuadra gjakovare, pasi ndali Prishtinën në barazim, shpreson ta rivalizojë edhe Rahovecin. Rahoveci ka fituar 22 ndeshjet e

deritashme dhe udhëheq në tabelë me 44 pikë. Vëllaznimi është i gjashti me tetë pikë. Vushtrria - Trepça është ndeshja tjetër e së shtunës mbrëma. Vushtrria është e parafundit me shtatë pikë, ndërsa Trepça e katërta me 26 pikë.



Befasi në NBA, munden dy ekipet kryesuese në Lindje

ATLANTA, 29 MARS - Vetëm dy ndeshje të luajtura së fundmi në NBA, por të dyja kanë dhuruar surpriza. Bostoni, kryesuesi i renditjes dhe rekordmeni në Konferencën e Lindjes, u mund 123-122 nga Atlanta pas kohës shtesë, në një ndeshje të

ekuilibruar deri në fund. Të gjithë titullarët e Boston Celticsit realizuan mbi 10 pikë, ku Tatum me 31 pikë më i miri, por që s'mjaftoi për të fituar. Ai që shkëlqeu për Atlantan ishte Mërrej, autor i 44 pikëve, më i miri në fushë. Gjithsesi, kjo nuk e

zbeh aspak sezonin e rregullt që po bën Bostoni, i cili u ndal vetëm nga një pikë diferencë. Zhgënjëu edhe ekipi i Milwaukee, që u mund 107-100 nga New Orleansit, që nuk zhgënjëu në fushën e tij. Williamsoni me 28 pikë e

MekKollum me 25 bënë diferencën për vendasit, ndërsa 35 pikët e Antetokounmpos mbetën për statistikë. Milouki mban vendin e dytë në Lindje, por shumë larg Bostonit, ndërsa Nju-Jorku ngjitet në vendin e tretë.



Marku, Kongos: Për të më rrahur duhet të më hedhë KO, do t'i tregoj se s'jam këtu rastësisht

TIRANË, 29 MARS - Boksieri i pamposhtur shqiptar Florian Marku këmbëngul se Chris Kongo, kundërshtari i tij mbrëmjen e së dielës, ka bërë një gabim kritik që ka pranuar sfidën me të. Kongo po e nënvlerëson shqiptarin, ndaj Marku, në një intervistë për "Sky Sports", thotë se do ta bëjë të paguajë për këtë. Armiqësia mes dy boksierëve nisi fillimisht me një grindje në një konferencë shtypi vitin e kaluar. Tani rivaliteti i tyre do të arrijë në një përfundim kur ata të duelojnë pas tri ditësh në Londër. "Ai tregoi mungesë respekti ndaj meje. Ai erdhi sikur të isha askushi, më ndërpreu intervistën dhe e shtyu", ka thënë Marku. "Ai pëlqen t'i ngacmojë njerëzit, por nëse e ngacmojmë atë, ai do të ndalet", ka shtuar më tej boksieri kuqezi. "Tani ai ka atë që dëshiron. Kjo është ajo që ai donte. Ai donte që kjo sfidë të ndodhte dhe tani ai e ka atë. Ne do të shohim më 31 mars nëse ai do të pendohet për zgjedhjen e bërë", u



shpreh Marku për mediet.

Marku paralajmëroi rivalin anglez: "Për të më rrahur duhet të më hedhë KO sepse unë nuk dorëzohem. Nuk më intereson çfarë do të sjellë sfida, unë do të bëj punën time dhe do ta përmbush ëndrën time sido që të jetë. Unë e di se sa shumë punoj, e di se çfarë jam i aftë. Më 31 mars do ta shohim. Unë do ta tregoj. Ai më nënvlerëson

mua, ashtu siç kanë bërë të gjithë. Ndoshta se unë vij nga një sport tjetër si MMA dhe kimboksi dhe nuk jam vërtet me përvojë në ring, por ata harrojnë se jam i pamposhtur. Kur ata janë brenda në ring me mua, e ndiejnë se sa shumë e dua fitoren, se sa ndryshe jam. Tani do t'i dëshmoj turmës dhe Kongos se nuk jam këtu se kam pasur fat", ka pohuar Marku.

Tare për 'Kicker': Shqipëria, vlerë e shtuar në 'Euro 2024'

Berlin, 29 mars - Igli Tare është një nga personazhet më të famshëm të futbollit shqiptar në arenën evropiane, një ish-lojtar i rëndësishëm, me një karrierë të pasur në kampionate elitare në Evropë, si Gjermani dhe Itali, por dhe një nga drejtorët sportivë më të vlerësuar në Serinë A. Pas largimit të tij nga Lazio, Tare është në kërkim të një projekti të ri, ndërsa një intervistë për prestigjiozët gjermane "Kicker", Tare zbuloi se pasi shijoi një periudhë relaksi pranë familjes, vijon të ndjekë nga pranë të gjithë ligat e mëdha, ndërsa së shpejti do të udhëtojë në Angli: "Shumë shpejt do t'i vizitoj Pep Guardiolën te Manchester City dhe Roberto De Zerbin te Brighton. Jam shumë i entuziazmuar për njohuritë që do të marr atje", u shpreh Tare, duke bërë më pas një koment rreth "Euro2024": "Jam 100% i bindur se



Gjermania do të jetë një nga katër skuadrat që do të luftojnë për titullin në Evropian, përkrah Spanjës, Francës dhe Italisë. Shqipëria? Do të jetë një vlerë e shtuar për Evropianin dhe, ndoshta, do të fitojë më shumë simpati nga të

gjithë në Gjermani. Në fushë dhe në tribuna. Fansat janë jashtëzakonisht entuziastë, fanatikë në sensin pozitiv. Fjala 'huligan' nuk ekziston në Shqipëri", theksoi Igli Tare në intervistën e tij të gjatë për të përditshmen gjermane "Kicker".

Shefi i Ferrarit: Red Bullin mund ta mposhtim si skuadër

Fitorja e dyfishtë në garën e Australisë ka rikthyer entuziazmin te Ferrari, që pas dy vendeve të treta në dy garat e para, tregoi se ka një makinë konkurruese. Gjithsesi, të "kokëkuqja" janë të vetëdijshëm se Red Bulli është

ende një hap përpara. Garat e ardhshme janë shumë të rëndësishme për ta vlerësuar ecurinë e mundshme të pjesës tjetër të kampionatit. "Ky është objektivi ynë, që Ferrari të jetë konkurrues për kampionatin e

konstruktorëve", ka thënë Frederic Vasseur, shef i makinës italiane. "Natyrshisht që ne duam edhe të luftojmë për kampionatin e pilotëve, por ndoshta ky vit është pak herët për këtë gjë, por do të shohim", u shpreh më tej

menaxheri francez i Formulës 1. "Kam respekt të madh për Carlos si njeri dhe si pilot. Kur i thashë për zgjedhjen e Hamiltonit, i premtuam vetes se do ta jepnim maksimumin deri në kthesën e fundit të garës së fundit", ka

deklaruar Vasseur. Ai përshkroi rrugën që duhet ndjekur: "Fundjavat nuk do të jenë të gjitha si në Melburn, por kërkojmë të mos bëjmë gabime, të përmirësohemi hap pas hapi dhe të mbajmë të njëjtin vendosmëri".

SHKURT

Vëllaznimi i merr pikë Prishtinës në ndeshjen e mbetur

Vëllaznimi e Prishtina e kanë luajtur të enjten mbrëmëra ndeshjen e mbetur të xhiros së 19 të Superligës së Kosovës në hendboll. Ndeshja në Gjakovë nuk ka dhënë fitues, duke përfunduar 47:47. Në pjesën e parë skuadra vendase u shkëput deri në pesë gola, 17:12. Por Prishtina u kthye dhe e fitoi pjesën e parë, 26:24. Në pjesën e dytë Prishtina ishte ajo që u shkëput deri në gjashtë gola, 34:28. Por vendasit nuk u dorëzuan. Madje në minutat e fundit dolën dy gola para, 46:44 e 47:45. Në minutën e fundit Vladyslav Napadailo e Altin Cacaj shënuan për barazimin 47:47. Egzon Lluka i shënoi 14 gola për Vëllazninin. 12 i kishte Arbër Neziri e 10 Besmir Kusari. Te Prishtina, Napadailo u ndal në 14 gola. Enis Kuleta i shtoi nëntë gola e Albi Gjuka tetë.

'Mundo Deportivo': Haalandi do të transferohet te Barcelona

Erling Haaland në vitin 2025 do të transferohet te Barcelona. Ky është lajmi i bujshëm që publikon "Mundo Deportivo". Barça do të rritet financiarisht vitin e ardhshëm dhe do ta ketë mundësinë për të shpenzuar për një lojtar si 23-vjeçari norvegjez. Në këtë formë, Barcelona do t'i kundërpërgjigjej Realit që është shumë pranë firmës me Kylian Mbappe, për të nisur kështu një tjetër rivalitet si ai i periudhës mes Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit. Në anën tjetër, Manchester City nuk do të heqë dorë lehtë nga ylli i saj.

Liverpooli heq dorë nga Alonso, mendon për Amorimin

Liverpooli raportohet se ka hequr dorë nga interesimi për trajnerin Xabi Alonso. Ky vendim ka ardhur pasi drejtuesit e klubit anglez mendojnë se tekniku spanjoll nuk dëshiron të largohet nga Leverkuseni pavarësisht prej kërkesave të ndryshme të klubeve të mëdha evropiane. Sipas gazetarit Fabrizio Romano, Liverpooli tashmë po mendon për trajnerin e Sporting, Ruben Amorim. Siç dihet, Jugen Klopp muaj më parë ka njoftuar se do të largohet nga Liverpooli në fund të sezonit.

UEFA pritet të marrë vendim, 26 futbollistë për një kombëtare në 'Euro 2024'

UEFA do ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së numrit të futbollistëve për skuadrat pjesëmarrëse në Evropianin 2024, nga 23 që është vendosur aktualisht, në 26. Reagimi i qeverisë evropiane të futbollit vjen pas thirrjes së bërë nga një numër i konsiderueshëm i trajnerëve të përfaqësuesve pjesëmarrëse, të cilët kërkuan rikthimin e rregullit të skuadrave me 26 futbollistë. Ndër emrat që shfaqën edhe publikisht qëndrimin e tyre ishin Gareth Southgate i Anglisë dhe Ronald Koeman i Holandës, të cilët theksuan se kalendari i ngjeshur mund të shkaktojë dëmtime të shumta dhe t'i penalizojë ekipet në fazat e caktuara të Evropianit. Mbledhja e radhës e UEFA-s është parashikuar të mbahet në Dusseldorf të Gjermanisë më 8 dhe 9 prill, teksa nga zyrat e qeverisë evropiane filtron optimizimi se do të vendoset për shtimin e numrit të futbollistëve në 26 për çdo skuadër. Ky vendim do t'i hiqte jo pak dhimbje koke edhe trajnerit të Shqipërisë, Sylvinho, që ka ende shumë dilema dhe me një listë me 26 futbollistë, do të mund të kënaqte thuajse të gjithë, duke i marrë në Gjermani për "Euro 2024". Vlen të theksohet se në Evropianin e kaluar, të mbajtur në 2021-shin në Angli, por edhe në Botërorin e Katarit më 2022, skuadrat u përfaqësuan me lista prej 26 futbollistësh.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "OSK Brokers" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811995383 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "OSK Brokers" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811995383 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "OSK Brokers" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811995383 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fisnik Thaçi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Fidan Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhemdin Nixha" Instalues Ujësjellësit-Kanalizimit.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

